

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
VITI 2025**

Nr. Rend or	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	.02.2025	Kujtim Topuzi, gazetar në Report Tv në bazë të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkoj të njihem me disa informacione nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara Report Tv, me qëllim sqarimin e publikut, kërkon të bëjë një shërbim në lidhje me fatin e pasurive të sekuestruara apo konfiskuara! Në lidhje me këtë ju lutem në vini në dispozicion informacionin për	17.02.2025	1)Në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si më poshtë: AAPSK po zhvillon aktualisht një inventarizim të plotë të pasurive/pronave të sekuestruara dhe konfiskuara, si edhe hedhjen e të dhënave në databazën përkatëse/regjistrin e pasurive. Pyetja nr. 1 Mënyra e destinimit të pasurive të paluajtshme që vijnë nga krimi i organizuar përcaktohet në nenin 25 pika 1 të ligjit nr.34/2019 i ndryshuar “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” si dhe VKM nr.888 datë 11.11.2020 “Për Përcaktimin e Kritereve të Vlerësimit, Mënyrat dhe Procedurat e Dhënies në Përdorim dhe të Tjetërsimit të Pasurive të Konfiskuara” Neni 25 pika 1 citon: “Komiteti Ndërinstitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar, me vendim, përcakton mënyrën dhe kushtet e përdorimit, destinimin e pasurive të konfiskuara dhe nxjerr udhëzimet shoqëruese të përdorimit, brenda 30 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit tekniko-	Me Email & shkresë zyrtare. E plotë	Pa pagesë

		pyetjet e mëposhtme: - 1. Cili është destinacioni i pasurive të paluajtshme që vijnë nga krimi i organizuar dhe korrupsioni? 2. Çfarë rruge ndjek një pasuri e paluajtshme e marrë nga krimi i organizuar deri në konfiskimin e plotë? 3. A kemi ndonjë rast kur një shtëpi apo biznes i konfiskuar është përdorur në shërbim të komunitetit, është shndërruar në institucion social? Nëse po, janë rastet më të veçanta? 4. Nëse mund të flasim për një rast specifik, çfarë ka ndodhur me biznesin "Santa Quaranta" në Sarandë? 5. Por rasti i Hotel Vollga në Durrës? 6. Si vijon të jetë raporti pasuri e sekuestruar nga pasuri e konfiskuar? 7. Hasni ju problematika në	<i>financiar dhe rekomandimet nga Agjencia, por jo më vonë se 120 ditë nga data e njoftimit të vendimit gjyqësor”.</i> Pyetja nr. 2 AAPSK është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara apo konfiskuara të cilat përfshihen në nenin 4 të ligjit Nr.34/2019 i ndryshuar, që përcakton fushën e veprimtarisë së saj. Neni 4 i ligjit nr.34/2019 i ndryshuar citon: <i>Dispozitat e këtij ligji zbatohen për:</i> a) <i>pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara me vendim të gjykatës kompetente, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit;</i> b) <i>pasuritë e bllokuara e të sekuestruara, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për masat kundër financimit të terrorizmit;</i> c) <i>pasuritë, për të cilat është vendosur masa e sekuestrimit preventiv, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, dhe ato të konfiskuara me vendim të gjykatës kompetente, sipas dispozitave të Kodit Penal, të cilat janë produkt i veprave penale apo të lidhura me to.</i> ç) <i>pasuritë për të cilat është vendosur masa e sekuestrimit ose e konfiskimit, sipas aktit normativ nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”;</i>		
--	--	---	---	--	--

		procesin e rishitjes së pronave dhe pse? Cilat janë këto problematikat kryesore? 8. Sa janë përfitimet e shtetit pas shitjes?	<i>d) provat materiale, sipas kuptimit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, me përjashtim të atyre të cilat ruhen në sekretari.</i> Pyetja nr. 3 Mbështetur në qëllimin e ligjit nr.34/2019 i ndryshuar, konkretisht <u>nenin 1 të</u> tij, AAPSK ka lidhur kontrata huapërdorje me përfitues të ndryshëm,pas vendimmarrjes së Komitetit Ndërinstitucional Për Masat Kundër Krimit të Organizuar, për qëllime sociale si psh : 1.Berat – 1 Apartament me destinacion banese sociale për strehimin e familjeve të pastreha. Me sipërfaqe 81 m², apartament me tipologji 2+1 me numër pasurie 6/233 + 1 - 20 2.Arsis – 2 Apartamente, nr pasurie 2/343 + 6 -38 , zk 8270 me sipërfaqe 80.6 m2 dhe apartamenti tjetër me sip 82.4 m² me nr pasurie 2/343 + 5 -27 zk 8270, OJF, nisma per ndryshim shoqëror Arsis me destinacion “Ofrimi i shërbimit të emergjencës për fëmijet dhe nënat në nevojë”. 3.Engim – Enti kombetar i Jozefinëve te Murialdos. (Objekt i kontratës huapërdorjes është pasuria e llojit njësi me nr. 2/40-N4 me sip 110.5 m², zk 8534 me vendndodhje lagjja ‘Apollonia” Fier. Destinacioni i përdorimit të objektit është në zbatim të projektit Ke Buono në bashkëpunim me qendrën sociale Murialdo financuar nga Agjencia Italiane e		
--	--	--	---	--	--

				Bashkëpunimit për zhvillim në kuadër të projektit RISE – ALB.		
				4.Engim- Bodrum me sip 85 m ² zk 8524 nr pas 4/216 me vendndodhje lagjja e re Elbasan. Zbatimi i projektit Rise ALB nga organizata Enti kombëtar i Jozefinëve te Murialdos ENGIM.		
				5.COVS Dhe organizata jofitimprurëse OJF ADAD Malore. Objekti i kontratës pasuri e paluajtshme e llojit arë me sip 2930 m ² , zk3225 nr pasurise 27/44 Shijak me destinacion zbatimi i projektit “Development of social farm, Healthy and sustainbile” nga ADAD Malore i financuar nga organizata COVS ne kuadër të projektit TOKA JONË.		
				6.COVS me OJF, Fondacioni i Joscelyn,është pasuri arë me sip 1000 m ² me zk 3866, nr pasurie 236/4 Yzberisht destinacioni është zbatimi i projektit “The Eorld of Huzelnuts” i financuar nga organizata Toka Jonë.		
				7.COVS me OJF, Levizja Eco Volis është pasuri arë me sip 1000 m ² me zk 3866, nr pasurie 236/3 Yzberisht destinacioni është zbatimi i projektit “Green Learning Farm, cultivating Sustainability in Young Groëers” nga organizata Levizja EcoVolis i financuar nga organizata COVS në Shqipëri në kuadër të projektit Toka Jonë.		
				8.Partnerët Shqipëri për ndryshim dhe zhvillim dhe OJF, Qendra “Durrresi Aktiv”, Apartament me sip		

				67.2 m2 zk8518 nr pasurie 39/146/ND+1-21, rruga Plazh Durrës, destinacioni i përdorimit të objektit “Zbatimi i projektit, developing arts – based social enterprise for positive community impact” ne kuadër të projektit TËIST. Tëist është “Toëards neë social entrepreneurship model in confiscated asset in Albania”.		
				Pyetja nr.4 Me Vendimin nr. 18 Datë 21.09.2020 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, janë konfiskuar pasuri në emër të shtetasit B.Balili, shoqërisë “BALILI-KO” etj.. Aktualisht AAPSK administron pasuritë e konfiskuara sipas ligjit nr.34/2019 si dhe është në proces gjyqësor me objekt “ Pjestim pasurie në bashkëpronësi” pasi Republika e Shqipërisë zotëron 40% të pasurisë dhe pjesa tjetër në masën 60 % zotërohet prej pronarit tjetër (B.Balili, BALILI-KO shpk) . Pyetja nr.5 Hotel Vollga në Durrës, është pasuri e konfiskuar me Vendimin nr.167 Datë 07.07.2021 të Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Më tej, kjo pasuri është marrë në administrim nga AAPSK si dhe Agjencia ka ndjekur të gjithë procedurat e administimit të saj, duke kaluar pasurinë në favor të shtetit si dhe duke kaluar atë për destinim në Komitetin Ndërintsitucional për Masat Kundër Krimit të Organizuar.		

				Komiteti Ndërintsitucional për Masat Kundër Krimin të Organizuar me Vendimin nr.67 dt. 29.07.2022 ka vendosur shitjen e 33.3% të pasurisë së konfiskuar me vendim të formës së prerë. AAPSK ka përcjellë dosjen e pasurisë për shitje pranë Drejtorisë së Shitjes në Strukturën Përgjegjëse për Shitjen e Pronës Publike por procedura nuk është finalizuar pasi nuk është paraqitur asnjë pjesëmarrës në ankand. Pyetja nr.6 Gjithnjë numri i pasurive të sekuestruara është me i lartë se numri i pasurive të konfiskuara, kjo për shkak edhe të vetë procesit, ku procesi i sekuestros preventive është proces i përkohshëm dhe më i shpejtë ndërsa procesi i konfiskimit është proces i cili zgjat më shumë në kohë dhe nuk ka karakter të përkohshëm. Pasuritë me status të sekuestruar mund edhe të revokohen nga gjykata . Pyetja nr.7 Problematika në procesin e rishtitjes nuk janë konstatuar. AAPSK ka të përcaktuar në kreun nr.V, të VKM nr.888 datë 11.11.2020 “<i>Për Përcaktimin e Kriteve të Vlerësimit, Mënyrat dhe Procedurat e Dhënies në Përdorim dhe të Tjetërsimit të Pasurive të Konfiskuara</i>” procedurën që ndiqet në rastin e shitjes së pasurisë me ankand.		
--	--	--	--	---	--	--

				Shitja e pasurive të konfiskuara është një proces i cili zhvillohet pranë strukturës përgjegjëse për shitjen e pronës publike pranë Drejtorisë së Shitjes Pronës Publike dhe e gjithë procedura zhvillohet nëpërmjet një ankandi publik. AAPSK vetëm përkatit dokumentacionin ligjor, dosjen për shitje. Pyetja nr.8 Pasi pasuritë e konfiskuara destinohen për shitje dhe ankandi publik përfundon duke u shitur pasuria e konfiskuar,të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë kalojnë në favor të shtetit , në buxhet por pasi të jenë zbritur shpenzimet e administrimit të pasurisë.		
2	12.02.2025	I nderuar/ E nderuar, Iniciativa Globale kundër Krimin të Organizuar Transnacional (GI-TOC) është një organizatë ndërkombëtare e shoqërisë civile me seli në Gjenevë. Aktualisht po kryejmë një studim shkencor mbi flukset financiare të paligjshme në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë Shqipërinë. Kërkimi ka për qëllim të thellojë kuptimin tonë		Në përgjigje të kërkesës suaj datë 12.02.2025, administruar në email zyrtar të koordinatorit për të drejtën e informimit, znj.S.Ibrahimi, ju informojmë si më poshtë vijon: Gjatë periudhës 1 janar 2019-31 dhjetor 2024, AAPSK nuk ka marrë në administrim asnjë pasuri të llojit kriptomonedhë. AAPSK, ka në organigramën e saj një staf prej 14 nëpunësish civilë (përfshirë këtu edhe titullarin e institucionit/Kryeadministratorin) ndërsa numri i administratorëve të cilët kontraktohen nga AAPSK për administrimin e pasurive, nuk është numër fiks pasi ndryshon vazhdimisht sipas nevojave institucionale. Aktualisht nuk kemi punonjës të	Me Email & Shkresë zyrtare E plotë	Pa pagesë.

	mbi përbërësit e këtyre flukseve dhe përpjekjet institucionale për t'i luftuar ato. Gjetjet dhe rekomandimet do të publikohen në raportin tonë periodik, Risk Bulletin, pas përfundimit të hulumtimit. Në këtë kuadër dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar për të drejtën e informimit publik, kërkojmë me mirësi informacionin e mëposhtëm për periudhën 1 janar 2019 – 31 dhjetor 2024: 1. Konfiskimi i kriptomonedhave: A keni hasur raste që përfshijnë konfiskimin e kriptomonedhave? Nëse po, si e vlerësoni vlerën e aseteve të konfiskuara në formën e kriptomonedhave? 2. Llojet dhe vlerat e kriptomonedhave të	specializuar për menaxhimin e aseteve të konfiskuara të llojit “kriptomonedha” dhe rasteve që përfshijnë teknologjinë blockchain. Ligji organik mbi të cilin organizohet dhe funksionon Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, është ligji nr.34/2019 “<i>Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara</i>” i ndryshuar. Ky ligj nuk përmban klauzola konkrete të cilat rregullojnë administrimin dhe menaxhimin e pasurive të llojit të veçantë “kriptomonedha”. Bashkëpunimi ndërkombëtar është gjithmonë i rëndësishëm, sin e shkëmbimin e informacionit, ashtu edhe praktikave më të mira mes autoriteteve homologe, jo vetëm për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara por edhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, është institucion publik, i cili nuk ka bashkëpunuar ndonjëherë me sektorin privat lidhur me platformat e këmbimit të kriptomonedhave, duke qënë se nuk ka patur raste të marrjes në administrim të pasurive të tilla. Duke qënë se ligji aktual nr. 34/2019 i ndryshuar “<i>Për Administrimin e Pasurive të sekuestruara dhe të Konfiskuara</i>” nuk parashikon rregullime ligjore për administrimin e pasurive të llojit “kriptomonedha”,		
--	--	---	--	--

	konfiskuara: Nëse ekzistojnë raste të tilla, cilat kriptomonedha janë konfiskuar dhe cilat kanë qenë vlerat e tyre? 3. Kapaciteti për të menaxhuar kriptomonedhat e konfiskuara: A ka agjencia juaj kapacitetin për të menaxhuar asetet e konfiskuara në formën e kriptomonedhave? 4. Sfidat në menaxhimin e asetëve të konfiskuara: Çfarë sfidash has agjencia juaj në menaxhimin e asetëve të konfiskuara, veçanërisht të kriptomonedhave? A dispononi një ekip të specializuar për të trajtuar rastet që përfshijnë teknologjinë blockchain dhe kriptomonedhat? 5. Nevoja për ndryshime legislative: A janë të nevojshme ndryshime ligjore për të rritur efikasitetin e	AAPSK nuk administron portofol zyrtar për menaxhimin e asetëve dixhitale të konfiskuara Rregulla më të detajuara lidhur me emetimin e monedhave virtuale, licensimin, monitorimin e subjekteve dhe mbajtjen e regjistrave dixhitalë, përcaktohen në Ligjin nr. 66/2020 <i>“Për Tregjet Financiare të Bazuara në Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë”</i>.		
--	--	--	--	--

		agjencisë suaj në konfiskimin dhe menaxhimin e kriptomonedhave? 6. Rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar: Sa i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërkombëtar në rastet që përfshijnë kriptomonedhat? A bashkëpunoni me agjenci të ngjashme në vende të tjera për këtë çështje? 7. Bashkëpunimi me sektorin privat: A bashkëpunoni me sektorin privat, si platformat e këmbimit të kriptomonedhave, për të lehtësuar procesin e konfiskimit? 8. Krijimi i një portofoli të kriptomonedhave: A ka krijuar agjencia juaj ose ndonjë autoritet tjetër në Shqipëri një portofol zyrtar për menaxhimin e aseteve dixhitale të				
--	--	---	--	--	--	--

		konfiskuara? Cila institucion duhet të jetë përgjegjëse për menaxhimin e një portofoli të tillë në Shqipëri? Ju lutemi të na ktheni përgjigje me email në anesa.agovic@globalinitiative.net				
--	--	--	--	--	--	--

3.	13.02.2025	Kërkohet informacion për një punim mediatik që do të realizohet në televizionin MCN ku kërkuesi punon si gazetar. 1.Sa raste referuar vendimeve të Gjykatës, kanë qënë pjesë e zbatimit të aktit normative Nr.1 datë 31.01.2020 në institucionin tuaj? 2.Sa prej këtyre rasteve menaxhohen si sekuestre dhe sa si konfiskime. Këtë informacion mund ta vini në dispozicion nëpërmjet postës elektronike. Oliverdaallmuca@gmail.com Adresa postare: Rruga e Vilave, Lundër Tiranë.	Në përgjigje të kërkesës suaj datë 13.02.2025, administruar në AAPSK nëpërmjet postës elektronike, ju informojmë si vijon: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara është institucioni përgjegjës për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara. Fusha e zbatimit të Ligjit nr.34/2019 i ndryshuar “Për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” përcaktohet në nenin 4 të tij, ku ndër të tjera përfshihen edhe pasuritë për të cilat është vendosur masa e sekuestros ose e konfiskimit, sipas Aktit normativ Nr. 1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”. Pyetja nr. 1 Referuar vendimeve gjyqësore të cilat kanë patur si bazë ligjore Aktin Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020 “Për Masat Parandaluese në Kuadër të Forcimit të Luftës Kundër Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Krimeve të Rënda dhe Konsolidimit të Rendit e Sigurisë Publike” në AAPSK, përgjatë vitit kalendarik 2022, janë përcjellë 47 raste, 37 raste përgjatë vitit 2023 dhe 3 raste përgjatë vitit 2024. Pyetja nr.2 Numri i rasteve të proceduara me Aktin Normativ nr.1 ka rënë nga viti në vit, duke qënë se, ky akt, ka patur karakter të përkohshëm, deri më 31.12.2020.	Me shkresë Zyrtare. E plotë	Pa Pagesë
----	------------	--	--	-----------------------------------	-----------

				a) Për vitin 2022, nga 47 vendime, 3 kanë caktuar masa sekuestro dhe 38 kanë caktuar konfiskim. b) Për vitin 2023, nga 37 vendime, 22 janë konfiskime, 4 revokime, 1 rast i dërguar për rigjykim dhe 10 raste në të cilat gjykata ka diposnuar pjesërisht konfiskim dhe pjesërisht revokim. c) Për vitin 2024, në 3 vendime të përcjella është vendosur konfiskim. d) Për vitin 2025, nuk na është përcjellë për ekzekutim asnjë rast sipas Aktit Normativ nr.1 datë 31.01.2020.		
4	05.03.2025	Të nderuar drejtues të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Erblin Vukaj dhe Citizens.al, ju lutet institucionit tuaj për vënie në dispozicion të dokumenteve/ informacioneve zyrtare në lidhje me pronat e sekuestruara dhe konfiskuara gjatë periudhës 2015-2025		Në përgjigje të kërkesës suaj datë 05.03.2025, administruar në adresën elektronike të AAPSK-së info@aapsk.gov.al, ju informojmë si më poshtë vijon: Pyetja nr. 1 Numri i përafërt i pasurive të sekuestruara sipas aktakuzës "Trafikim lëndësh narkotike" gjendje në AAPSK, deri në periudhën 31.12.2024 është 413, përkatësisht me vlerë 1 391 989 279.56 dhe të konfiskuara janë në total 153 pasuri, përkatësisht me vlerë 1 247 813 174.30.	Me email zyrtar	Pa pagesë

		nën dyshimin se janë produkt i veprimtarisë kriminale të trafikut të drogës. -Redaksia e Citizens po punon për realizimin e një dokumentari në lidhje me zgjatjen dhe shirirjen e krimit të organizuar nga Shqipëria në vendet e Amerikës Latine - dhe e kundërta. -.Për këtë interesohemi të kemi të dhëna, apo informacione zyrtare për sa më poshtë: 1. Sa pasuri janë sekuestruar dhe konfiskuar gjatë periudhës 2015-2025 nën dyshimin se janë produkte të pastrimit të parave nga trafiku i drogës? 2. Çfarë kategorie pasurish janë sekuestruar më së shumti (prona, biznese, para cash, automjete, etj.)?		Pyetja nr. 2 Pasuritë e sekuestruara më së shumti, janë pasuri të paluajtshme të llojit apartamente, njësi, toka arë/truall, pasuri të luajtshme të llojit automjete, por nuk mungojnë as pasuritë llogari bankare, shoqëri tregtare. Pyetja nr. 3 Rastet kur pasuritë që i ngarkohen AAPSK-së për administrimin, janë në zotërim të subjekteve të cilët janë proceduar penalisht jashtë vendit, nuk janë të pakta, por është objektivisht e pamundur të mund të identifikojmë nëse prej tyre ka vendime që lidhen me grupe kriminale të Amerikës Latine. Pyetja nr. 4 Ne favor të shtetit janë kthyer përafërsisht 153 pasuri, ndërkohë që nuk kemi një informacion të saktë, mbi sa janë kthyer te pronarët për mungesë provash. Sic ju informuam më sipër, AAPSK nuk e disponon këtë informacion. Pyetja nr.5 Po, ka patur raste kur janë sekuestruar shoqëri ndërtimi të dyshuara për pastrim parash nga trafiku i drogës.	
--	--	--	--	--	--

		3. A ka pasuri të sekuestruara ose të konfiskuara që lidhen drejtpërdrejt me grupe kriminale të Amerikës Latine? 4. Sa prej këtyre pasurive janë rikthyer në favor të shtetit dhe sa janë kthyer te pronarët për mungesë provash? 5. A ka pasur raste ku janë sekuestruar kompani ndërtimi të dyshuara për pastrim parash nga trafiku i drogës?				
--	--	--	--	--	--	--

6.	13.03.2025	Pershendetje, në bazë të Ligjit nr.119/2014 “<i>Pë të drejtën e inormimit</i>” ërkoheh informacion si më poshtë: Për periudhat janar 2025-Shkut 2025, sa është numri i aseteve dhe shuma e të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe konfiskuara dhe sa ka qënë ky nr gjatë se njëjtës periudhë të një viti më parë (Janar 2024-Shkurt 2024) Gazetar Ervin Leks Email:ervinsleka@gmail.com	1.Shuma e të ardhurave nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara: <table><tr><th>Viti</th><th>Janar</th><th>Shkurt</th></tr><tr><td>2025</td><td>15,195,977.00</td><td>15,129,132.00</td></tr><tr><td>2024</td><td>8,434,728.47</td><td>8,252,462.00</td></tr></table> 2. Numri i aseteve të sekuestruara & konfiskuara për periudhën Janar-Shkurt 2024, 2025. <table><tr><th>Viti 2024</th><th>Janar -Shkurt</th></tr><tr><td>Sekuestruara</td><td>264</td></tr><tr><td>Konfiskuara</td><td>13</td></tr></table> <table><tr><th>Viti 2025</th><th>Janar -Shkurt</th></tr><tr><td>Sekuestruara</td><td>27</td></tr><tr><td>Konfiskuara</td><td>0</td></tr></table>	Viti	Janar	Shkurt	2025	15,195,977.00	15,129,132.00	2024	8,434,728.47	8,252,462.00	Viti 2024	Janar -Shkurt	Sekuestruara	264	Konfiskuara	13	Viti 2025	Janar -Shkurt	Sekuestruara	27	Konfiskuara	0	Me shkresë zyrtare& email.	Pa pagesë.
Viti	Janar	Shkurt																								
2025	15,195,977.00	15,129,132.00																								
2024	8,434,728.47	8,252,462.00																								
Viti 2024	Janar -Shkurt																									
Sekuestruara	264																									
Konfiskuara	13																									
Viti 2025	Janar -Shkurt																									
Sekuestruara	27																									
Konfiskuara	0																									

7.	26.03.2025	Kërkesë për informacion, mbështetur në Ligjin Nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit”i ndryshuar. Znj.Kostandina Këruti. Adresa postare: Rruga Elbasanit, Kati 10, ap.73, Tiranë Adresaletroneke: kkeruti@partnersalbania.org Nr.042254883 1. A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat jofitimprurëse (OJF) gjatë vitit 2024? 2. Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)? 3. Sa OJF kanë aplikuar për mbështetje financiare	Znj.Kostandina Këruti Në përgjigje të kërkesës suaj datë 26.03.202, drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Ministrisë Brendshme, Z. Ardian Biti, administruar më datë 27.03.2025 në adresën e postës elektronike zyrtare të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuetruara, Znj. Sara Ibrahim, ju informojmë si vijon; - Referuar verifikimeve të kryera, gjatë vitit 2024, nuk rezulton asnjë kërkesë e administruar nga organizata jofitimprurëse, drejtuar AAPSK-së për financim. Si rrjedhojë, nga ana jonë nuk është kryer financim për këto subjekte. - Në lidhje me bazën ligjore mbi mbështetjen jo financiare, ju bëjmë më dije se: në VKM-së nr. 888, datë 11.11.2020 <i>”Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”</i>, ndër të tjera përcaktohet dhënia në huapërdorje për subjekte të tjera përfituese, për të cilën Kryeadministratori mund t’i kërkojë Komitetit Ndërinstitucional për Masat kundër Krimit të Organizuar miratimin për dhënien me huapërdorje të pasurisë së konfiskuar, për subjektet e - tjera përfituese, duke i paraqitur argumentet përkatëse. Edhe në këtë rast, AAPSK, gjatë vitit 2024, nuk ka patur kërkesa të tilla, e si	Me email & shkresë zyrtare.	Pa pagesë.
----	------------	---	---	-----------------------------	------------

		gjatë vitit 2024? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes, nëse ka patur më shumë se një formë. 4. Sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Ju lutem, specifikoni sipas formës së mbështetjes nëse ka patur më shumë se një formë. 5. Cila ka qenë buxheti i disbursuar për organizatë dhe në total? Ju lutem, specifikoni sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë rregullon këtë formë mbështetjeje? 6. Keni ofruar mbështetje jofinanciare gjatë vitit 2024? Cila është baza ligjore/ rregullatore që 7. Nëse keni ofruar mbështetje financiare,		pasojë, nuk është dhënë asnjë mbështetje jo financiare. AAPSK nuk ka kompetencë për të hartuar projektligje/akte nënligjore e për pasojë, nuk ka organizuar konsultime publike gjatë vitit 2024, nuk ka koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik apo/dhe koordinator për shoqërinë civile dhe përfaqësues të OJF-ve nuk janë të përfshirë në organe këshillimore të këtij institucioni.		
--	--	--	--	--	--	--

		sa OJF kanë përfituar nga kjo mbështetje? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar (mjedise, trajnime, ndarje eksperiencash, etj)? 8. Sa është numri i konsultimeve publike të realizuara nga institucioni juaj gjatë vitit 2024? 9. A ka institucioni juaj koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 10. A ka institucioni juaj koordinator për shoqërinë civile? Nëse po, ju lutem citoni kontaktin. 11.Sa OJF kanë marrë pjesë në konsultime publike të organizuara nga Institucioni juaj?				
--	--	---	--	--	--	--

		12. Sa përqind (%) e projektligjeve / akteve nënligjore të hartuara nga institucioni juaj janë si rezultat i konsultimeve me OJF-të? 13. A janë të përfshirë përfaqësues të OJF-ve në organe këshillimore të institucionit tuaj? Nëse po, cilat janë këto organe këshillimore dhe sa OJF janë të përfshirë në to? 14. A janë të përfshirë OJF në grupet e punës së ngritura të institucionit tuaj? Nëse po, cilat janë këto grupe pune dhe sa OJF janë të përfshirë në to				
--	--	--	--	--	--	--

8.	02.04.2025	Kërkesë për informacion, mbështetur në Ligjin Nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit”i ndryshuar. Z.Taulant Koplikaj. AdreAleksander Moisiu, Kinostudio, AA Company, Tiranë +355684343444 A pranon më dhera nga bashkia e Tiranës Lanfilli i Sharrës, i cili administrohet nga Agjencia e Administrimit te Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara?		I nderuar z. Koplikaj, Në përgjigje të shkresës tuaj, "Kërkohet informacion lidhur me depozitimin e dherave nga Bashkia Tiranë", administruar në AAPSK me nr. 1143 Prot., datë 05.03.2025, ju bëjmë me dije se, Në vijim të informacioneve të vazhdueshme të vena në dispozicion nga Shoqëria "Integrated Energy BV SPV" sh.p.k., aftesia pritëse në Landfillin e Sharrës, për tipologjinë “Dhera”, është drejt ezaurimit dhe, për këtë arsye, shoqëria ka nisur një proces ristrukturimi të hapësirave të saj. Deri në përfundim të këtij procesi, është i pamundur pranimi i dherave nga Bashkia e Tiranës. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,	Me shkresë zyrtare.	Pa pagesë. E plotë.
----	------------	---	--	--	---------------------	-----------------------------------

9.	04.04.2025	Kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion dokumentacioni mbështetur në Ligjin Nr.119/2014 “ Për të drejtën e informimit”i ndryshuar E nderuar Znj. Ibrahim, Desada Sadiku dhe Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, në bazë të ligjit Nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, Neni 3, ju lutet institucionit tuaj për vënie në dispozicion: -një kopje të dokumentit dhe informacioneve zyrtare të përditësuara në lidhje me konfiskimin	Në përgjigje të kërkesës suaj datë 04.04.2025, administruar më datë 04.04.2025 në adresën e postës elektronike zyrtare të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, pranë Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara, Znj. Sara Ibrahim, ju informojmë si vijon: Pasuria e llojit tokë arë, me nr.36/361/1, me sipërfaqe 5512m², Gjilek-Perivolo, në pronësi të shoqërisë AG.TCC shpk, është sekuestruar me Vendimin nr. 107, datë 28.09.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në zbatim të vendimit të sipërcituar dhe Ligjit nr. 34/2019, i ndryshuar “<i>Për Administrimin e Pasurive të Sekestruara dhe të Konfiskuara</i>” është kryer ekzekutimi i vendimit dhe pasuria aktualisht është në administrim të AAPSK-së. Bashkëlidhur gjeni Vendimin nr. 107, datë 28.09.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.	Me email.	Pa pagesë. E plotë.
----	------------	--	--	-----------	-----------------------------------

		e tokës truall me nr. ngastre 36/36/1, me sipërfaqe 5512 m² në vendin e quajtur “Perivolo”, fshatin Gjilek, Himarë, me vendim nr.107, më 28.09.2023 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. “Kërkuesit i vihet në dispozicion një kopje e plotë e dokumentit zyrtar, për të cilin kërkon të informohet. Për çdo komunikim tjetër me qëllim orientimin dhe sqarimin e paqartësive, mund të më kontaktoni edhe në:Desada Sadiku Rr.Shefqet Musaraj 14, H.1, Ap.19, 1001, Tiranë.				
--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--